



KONKURS PËR PUNË

Pozita:	Menaxher/e e Projektit
Nr. i referencës:	03/2020
Vendi:	Prishtinë
Lloji i kontratës:	Orar i plotë
Kohëzgjatja e kontratës:	6 muaj, me mundësi vazhdimi

Informata mbi organizatën

Misioni i D4D-së është të ndikoj në proceset e zhvillimit të politikave publike në mënyrë që të përshpejtoj zhvillimin socio-ekonomik të vendit, përmirotoj qeverisjen dhe të përforcoj kulturën demokratike në Kosovë.

Nën mbikëqyrjen e Drejtores Ekzekutive, i/e punësuar/a do të ushtror detyrat e menaxhimit të projektit gjatë implementimit të projektit specifik në përputhje me fushën e programit të organizatës për interesin publik dhe/apo kërkesave të donatorit.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- › Menaxhimi i projektit dhe implementimi i aktiviteteve me përkushtim dhe profesionalizëm të lartë, dhe në rast nevojë të bëjë hulumtim përkitazi me fushën e projektit në implementim;
- › Ndihmoj në definimin e fushës së projektit dhe aktiviteteve, duke përfshirë të gjithë hisedarët dhe duke siguruar realizueshmëri teknike;
- › Përgatitja e një plani pune të detajuar për të monitoruar dhe ndjekur progresin e projektit gjatë gjithë periudhës së implementimit;
- › Realizimi e plotë të të gjitha aktiviteteve të projektit brenda kohës, fushës dhe buxhetit të projektit.



- › Parashikimi i rreziqeve të mundshme të projektit dhe të siguroj adresimin e duhur të çfarëdo problemi që del gjatë implementimit të projektit përmes masave adekuate;
- › Krijimi dhe mbajtja e marrëdhënieve pozitive me hisedarët e projektit, dhe informimi i tyre mbi të arriturat e projektit gjatë implementimit përmes shpërndarjes në rrjete sociale apo përmes kanaleve të tjera komunikimi;
- › Hartimi i raporteve mbi realizimin e objektivave të projektit sipas kërkesave të punëdhënësit dhe/apo donatorit të projektit;
- › Realizimi i detyrave dhe përgjegjësi të tjera të kërkuara nga punëdhënësi.
- › Gatishmëri për të udhëtuar së paku dy herë në vit në Shqipëri në kuadër të projektit, sipas planit të projektit.

Përvoja dhe kualifikimet:

- › Të ketë të përfunduar së paku studimet të nivelit Bachelor në shkencat sociale, avantazh do të kenë personat që kanë të kryer nivelin master;
- › Përvojë pune së paku tri (3) vite në menaxhim të projekteve, e preferuar në sektorin joqeveritar;
- › Shkathtësi të mira analitike dhe të shkrimit;
- › Gatishmëri për të punuar me fleksibilitet dhe në mënyrë të pavarur me mbikëqyrje minimale;
- › Shkathtësi për të punuar nën presion dhe të marrë vendime të shpejta dhe adekuate gjatë implementimit të projektit;
- › Aftësi të shkëlqyera komunikimi;
- › Njohuri të kënaqshme kompjuterike, veçanërisht në përdorimin e paketës MS Office;
- › Njohuri e shkëlqyeshme e gjuhës shqipe dhe angleze (të shkruar dhe të folur);



www.d4d-ks.org

Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

Si të aplikoni?

Të interesuarit duhet të dërgojnë në vacancies@d4d-ks.org dokumentet në vazhdim:

- > **CV**
- > **Letër Motivuese**

Mungesa e ndonjërit prej dokumenteve të renditura më lartë nënkupton refuzim të menjëhershëm të aplikimit për këtë pozitë pune.

Vetëm kandidatët që plotësojnë kriteret e kërkuara hyjnë në rrethin e ngushtë dhe do të ftohen për intervistë. D4D rezervon të drejtën e anulimit të konkursit.

Data e fundit për aplikim është 11 mars 2020.

Më shumë informata rreth D4D-së dhe aktiviteteve mund të gjeni në www.d4d-ks.org.